

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

Datë/a:	19.09.2018
Për/ Za/ To:	" Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T.P. " Ulpiana "; " MATI " SH.P.K. , Prishtinë
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 18.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik ""Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T.P. " Ulpiana "; " MATI " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ""Rikonstruimi i rrugëve Drenica,Ukshin Hoti,Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistruktues së rrugës Enver Maloku", me Nr. të Prok: 616-18-070-521nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik ""Grupi i Operatoreve Ekonomik N.T.P Ulpiana dhe Mati SH.P.K" të dt. 17.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rikonstruimi i rrugëve Drenica,Ukshin Hoti ,Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistruktues së rrugës Enver Maloku", me Nr. të Prok: 616-18-070-521, kundër Vendimit të AK -së, të datës 14.09.2018.
2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 14.09.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull ""Rikonstruimi i rrugëve Drenica,Ukshin Hoti,Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistruktues së rrugës Enver Maloku"", me Nr. Brendshëm 616 18 070 521 ta vazhdoj me vendimin për Anulim e dhënies së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 10.07.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: ""Rikonstruimi i rrugëve Drenica,Ukshin Hoti,Robert Doll dhe asfaltimi i shtresës së fundit të mbistrukturaes së rruges Enver Maloku"", me Nr. Brendshëm 616 18 070 521, **procedura e hapur**.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 02.08.2018. Janë dorëzuar gjithsejtë 3 oferta .Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të tenderëve.

Me datë 14.09.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE""Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T.P. " Ulpiana ": " MATI " SH.P.K., me dt. 17.09.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim., kundër vendimit të AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:pretendon se është eliminuar pa të drejt nga ky aktivitet për mungesë të paisjeve*

I. Baza ligjore

Ne lidhje me dispozitat e shkelura të LPP-se për të cilat pretendon OE Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T.P. " Ulpiana ": " MATI " SH.P.K.", Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje të plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, respektivisht në harmoni me kërkesat teknike profesionale.

Ua përkujtojmë se në Aneksin 7 të Dosjes:Lista e paisjeve në pikën 5 është kërkuar që të keni grejder me peshë prej 12-16 tonë.

Ju nuk keni plotësuar atë aneks por keni paraqitur një listë vetanake dhe në pikën 10 të pjesës Eskavatorët keni paraqitur Grejderin Atlas 1602 me peshë 8 tonë,ndërsa Deklaratën doganore për grejderin O&K Tip G 8 me peshë totale 8260,e që d.t.th.se asnjë nga mjetet nuk plotëson kërkesën e paraqitur në aneksin 7.

Bazuar në sqarimin paraprak konsideroj se pretendimi juaj është i pa bazuar, respektivisht refuzimi i tenderit tuaj ka qenë i bazuar, pasi që nuk keni dorëzuar dëshmi për posedimin e mjeteve sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

pp: ZEKEI BAKODHIAZ